



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 15.5.2015, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaç-Bujupi.

Munguan: Doruntinë Maloku, Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini- praktikantë në Kuvend; Etleva Ikonja- Kosova Sot; Valdet Hajdini-IKD; Lekë Batalli-GLPS; Fitore Hajdini-ZPRK; Flora Uka-CRPK; Florina Merovci-ZPRK; Baki Gimolli-MD.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i pakos së projektligjeve

Kryetarja – Është e papranueshme që me një procedurë të përshpejtuar të shqyrtohen ligjet kryesore sistimore, duke ditur dendësinë e këtyre projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin. Pra, është e papranueshme që të kalojnë me procedurë të përshpejtuar brenda një jave, e më pas të miratohen në leximin e dytë. Edhe në planin e veprimit që e kemi miratuar si Komision, kemi paraparë të organizohen dëgjime publike, grupe punuese për këto projektligje për ndryshimin dhe plotësimin, mirëpo në pamundësi të kohës, ne jemi dakorduar që të kemi vetëm një dëgjim publik në bashkëpunim me KDI-në, do të debatojmë kryesisht për Prokurorin e Shtetit, kurse projektligjet tjera për ndryshim dhe plotësim, ua u kam dërguar me email shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të fushave përkatëse që të na i dërgojnë rekomandimet e tyre me shkrim. Afati kohor për sjelljen e këtyre projektligjeve në Kuvend, ka qenë 31 mars, kurse janë sjellë në muajin maj. Kjo tregon se Ministria e Drejtësisë nuk e ka respektuar afatin kohor që vetë e ka propozuar. Tani po detyrohem që këto ligje sistimore dhe tepër të rëndësishme që t'i procedojmë shpejt. Kjo nuk është mirë, sepse do të vijmë në një situatë të mëvonshme që përsëri t'i ndryshojmë. Përkundër kësaj kohe të shkurtër, kam nxjerrë vërejtjet që kanë të bëjnë me këto projektligje. Një vërejtje substanciale është tek emërimi dhe trajnimi i gjyqtarëve, më pas sistemi i pagave, veprimtaria shkencore dhe e ligjërimit. Po ashtu, theksoi se fokusi i Komisionit duhet të jetë më shumë në çështjet më substanciale apo më përmbajtjesore.

Armend Zemaj – Pajtohet lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për gjykatat, por duhet fokusuar edhe në projektligje tjera, sepse kanë ndërlidhje të gjitha këto projektligje.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

I. Të miratohen, në parim projektligjet:

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;

Projektligji për kompensimin e viktimave të krimit.

II. *Formohen grupet punuese për shqyrtimin e projektligjeve si vijon:*

1. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, në përbërje: Armend Zemaj-*kryesues*, Donika Kadaj-Bujupi, Selville Halimi, Agim Ademaj-anëtarë.
2. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në përbërje: Albulena Haxhiu- *kryesuese*, Armend Zemaj, Nezir Çoçaj, Danush Ademi-anëtarë.
3. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në përbërje: Donika Kadaj-Bujupi - *kryesuese*, Selville Halimi dhe Agim Ademaj-anëtarë.
4. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në përbërje: Albulena Haxhiu-*kryesuese*, Armend Zemaj, Nezir Çoçaj dhe Danush Ademi-anëtarë.
5. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit, në përbërje: Armend Zemaj- *kryesues*, Donika Kadaj-Bujupi, Selville Halimi dhe Agim Ademaj-anëtarë.

III. Ekspertë për shqyrtimin e projektligjeve të cekur në pikat 1,2,3 dhe 4, caktohen: Besim Kelmendi, Sali Mekaj dhe Enver Peci.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu